

VENDIM
Nr. 187, datë 25.4.1997

PËR ZBATIMIN E PËRKOHSHËM, QË NGA MOMENTI I NËNSHKRIMIT, TË
“MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKË TË SHQIPËRISË DHE
QEVERIVE TË SHTETEVE KONTRIBUESE NË FORCËN MBROJTËSE
SHUMËKOMBËSHE PËR STATUSIN E KËSAJ FORCE”

Në mbështetje të nenit XIV, pika 2 të marrëveshjes së lartpërmendur, duke u nisur nga nevoja urgjente e zbatimit të menjëhershëm të kësaj marrëveshjeje, për shkak të pranisë aktuale në Shqipëri të forcave mbrojtëse shumëkombëshe, me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të fillojë zbatimin e përkohshëm, që nga momenti i nënshkrimit, të “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe qeverive të shteteve kontribuese në forcën mbrojtëse shumëkombëshe për statusin e kësaj force”, nënshkruar në Romë, më 21.4.1997, deri në ratifikimin e saj nga Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Brendshme që, në bazë të dispozitave të marrëveshjes, të marrin të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e përmbajtjes së saj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino